



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 821/2 prot.

Tiranë, më 30.11.2023

V E N D I M
Nr. 44, datë 30.11.2023

P Ë R
PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE MAGJISTRATË DHE KANDIDATË PËR
NDIHMËS LIGJOR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe pas miratimit të listës së kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar nga ana Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në mbështetje të neneve 248 dhe 266 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe vendimeve nr. 642; 643; 644; 645; 646; 647; 648; 649; 650; 651; 652; 653; 654; 655; 656; 657; 658, datë 26.10.2023, të vendimeve nr. 676, 677; 678; 679; 680; 681 datë 8.11.2023 të vendimit nr. 690 datë 15.11.2023 të KLGJ-së, dhe vendimit nr. 363 datë 13.11.2023, vendimit nr. 333 datë 27.10.2023, 384, datë 30.11.2023 të KLP-së, si dhe Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 30.11.2023,

V E N D O S I:

1. Të publikojë listën e kandidatëve për magjistratë dhe kandidatëve për ndihmës ligjor që pranohen në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2022- 2023 dhe 2023 – 2024, sipas listës bashkëngjitur, pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 824 / prot.

Tiranë, më 30.11.2023

V E N D I M
Nr. 45, datë 30.11.2023

PËR
TRAJTIMIN FINANCIAR TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË DHE
KËSHILLTARË/NDIHMËS LIGJORË QË KALOJNË ME VONESË PROCESIN E
VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS

Në mbështetje të neneve 248, 267, 268 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenit 19 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë”, Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, si dhe rekomandimeve të auditit të brendshëm sipas shkresës nr. 17302/3 prot., datë 9.12.2022, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 30.11.2023:

K O N S T A T O I:

Zbatimi i detyrimit ligjor, sipas ligjit nr. 96/2016, neni 32, “Verifikimi i pasurisë dhe figurës”, i cili parashikon se: “...5. deri në datë 5 Shtator të çdo viti, këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre... 7. Pas përfundimit të pasurisë dhe të figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës...”, nuk është përmbushur nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Gjithashtu, zbatimi i detyrimit ligjor, sipas ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë”, i cili parashikon se: “...87. Në përfundim të

procedurës së verifikimit, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos në lidhje me kualifikimin e kandidatit fitues dhe lejimin e tij për ndjekjen e programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose ndihmës ligjor në gjykatat e apelit. 88. Këshilli vendos skualifikimin e kandidatit dhe ndalimin e tij për ndjekjen e programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, nëse ai nuk kalon verifikimin e pasurisë ose figurës...”, nuk është përmbushur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në këto kushte, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, prej vitit 2019, ka lejuar që konkurrentët e shpallur fitues, edhe pse ende të pakonfirmuar nga Këshillat, të marrin pjesë rregullisht në aktivitetin akademik të Shkollës, në mënyrë që të mos cenohen në të drejtën e tyre për nisjen e Programit të Formimit Fillestar trevjeçar dhe përfundimin e këtij programi sipas viteve akademike kur ata janë shpallur fitues të konkursit të pranimit.

Për shkak se ligji parashikon që pagesat e tyre me bursë studimi mund të bëhen vetëm pas konfirmimit nga këshillat dhe lidhjes së marrëveshjes me Shkollën e Magjistraturës, Shkolla ka nisur pagimin e bursave për kandidatët pas këtij momenti.

Në zbatim të ligjit nr. 114, datë 6.11.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe marrëveshjes së bashkëpunimit me nr. 3308/2 prot., datë 2.3.2022, “Për kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”, u zhvillua një mision auditimi për periudhën janar 2019 - shtator 2022, dhe nga grupi i auditimit u paraqit rekomandimi, si më poshtë: “*Shkolla e Magjistraturës të lidhë marrëveshje regjistrimi për kandidatët fitues të pranuar nga KLGJ-ja dhe KLP-ja, dhe marrëveshje regjistrimi paraprake me kandidatët e shpallur fitues në procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës, me qëllim trajtimin e barabartë të kandidatëve magjistratë që frekuentojnë rregullisht programin. E drejta e përfitimit financiar të kandidatëve në proces verifikimi, të fillojë në të njëjtën kohë me kandidatët e pranuar, ndërsa ekzekutimi i saj, të kryhet pas pranimit nga KLGJ-ja dhe KLP-ja.*”

Po ashtu, kandidatët kanë nisur kërkimin gjyqësisht të bursave të papaguara për periudhën kur nuk kanë qenë të konfirmuar nga Këshillat dhe Gjykata Administrative ka vendosur për pranimin e kërkesave të tyre dhe shpërblimin për periudhën e papaguar të bursës së shkollimit (Vendim nr. 520 datë 08.03. 2023, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë).

Këshilli Drejtues vlerëson se kandidatët të cilët konfirmohen nga Këshillat do të duhet të përfitojnë nga bursa e shkollimit prej momentit kur ata kanë nisur procesin mësimor, pavarësisht momentit se kur janë konfirmuar. Shkolla e Magjistraturës do të detyrohet të paguajë bursat e shkollimit pasi të ketë verifikuar edhe momentin se kur kandidatët kanë shkëputur marrëdhëniet financiare me punëdhënësin e mëparshëm.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Kandidatët për magjistratë dhe kandidatët për këshilltar/ndihmës ligjor, të cilët kanë ndjekur rregullisht procesin mësimor dhe kanë shkëputur marrëdhëniet e mëparshme financiare, ju njihet periudha e studimit dhe të gjitha vlerësimet e vazhdueshme të marra

gjatë asaj periudhe, si dhe përfitojnë bursën e shkollimit për gjithë periudhën e formimit fillestar, pas kalimit me sukses të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.